



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI”
REKTORI**

Departamenti i **Administrim Biznesit** në *Fakultetin Ekonomik* në Universitetin e Elbasanit “Aleksander Xhuvani” për nevojat e tij, për mbulim të nevojave të procesit mësimor, për vitin akademik 2022-2023 shpall konkurs për personel akademik me kohë të pjesshme.

Kriteret e **përgjithshme e të veçanta** për pozicionin e punës **personel akademik me kohë të pjesshme janë:**

1. Kandidati duhet të ketë përfunduar studimet universitare (Ba dhe Master i Shkencave ose ekuivalente me të) brenda ose jashtë vendit në profilin **Administrim Biznes** me mesatare mbi 8.0. (Diplomat e lëshuara nga Institucionet e huaja të Arsimit të lartë dhe Institucione të tjera të autorizuara jashtë vendit, duhet të jenë njohur dhe njësuar paraprakisht nga Ministria përgjegjëse për Arsimin në Shqipëri).
2. Preferohen kandidatë me gradën Doktor i Shkencave në fushën e administrim biznesit. Gradat e fituara brenda ose jashtë vendit e lëshuara nga Institucionet e huaja të Arsimit të lartë dhe Institucione të tjera të autorizuara jashtë vendit, duhet të jenë njohur dhe njësuar paraprakisht nga Ministria përgjegjëse për Arsimin në Shqipëri)
3. Të ketë përvojë dhe të jetë i angazhuar në mësimdhënie në lëndë të specialiteteve në IAL, brenda dhe jashtë vendit.
4. Të jetë i angazhuar në kërkimin shkencor.
5. Të ketë përvojë pune pranë institucioneve private dhe publike.
6. Kandidati duhet të zotërojë të paktën një gjuhë të huaj të BE-së të mbrojtur dhe e vërtetuar me dëshmi.
7. Ndaj kandidatit të mos jetë marrë masë disiplinore e largimit nga puna.
8. Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë nga gjykata.

Kandidatët **duhet të dorëzojnë** nga data **14.09.2022 - 23.09.2022** këto dokumente

1. Kërkesë me shkrim (Plotësimi i formularit të aplikimit)
2. Jetëshkrimi.
3. Kopje të diplomës dhe të listës së notave. (Diplomat e lëshuara nga Institucionet e huaja të Arsimit të lartë dhe Institucione të tjera të autorizuara jashtë vendit, duhet të jenë njohur dhe njësuar paraprakisht nga Ministria përgjegjëse për Arsimin në Shqipëri).
4. Dokumentacionin shoqëruar përkatës origjinal ose të noterizuar sipas plotësimit të kriterëve të shpallura etj.
5. Vërtetim punësimi nga punëdhënësi për eksperiencën e punës.
6. Vërtetim i gjendjes gjyqësore (Dëshmi penaliteti)
7. Raporti i aftësisë në punë.
8. Fotokopje e letërnjoftimit.
9. Librezë shëndetësore.
10. Leje nga punëdhënësi për mësimdhënie në UE



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI”
REKTORI**

Përveç konkurrimit me dosje aplikantët do t'i nënshtrohen *intervistës* në departament.

Dokumentacioni i kërkuar mund të dorëzohet në **rrugë postare 14.09.2022** deri **23.09.2022**.

Adresa postare:

**Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”,
Rruga “Ismail Zyma”,
Aplikim në Fakultetin Ekonomik
Departamenti i Administrim Biznesit
Elbasan**